VENDIM
Nr. 126, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "FUTURE ENERGY AL" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2,germa"a"; 9 dhe 13, pika 1, germa"d"të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar,neneve 4, pika 1, germa"g"; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Future Energy AL" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë "Future Energy AL" sh.p.k., plotëson pjesërishtkërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.

Mungon vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata që personi nuk është i përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskalështë i plotësuarnë mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa"a" e plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 4/10, germa"b" e plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 4/10, germa "c" e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/tëpjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesëkëto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë"Future Energy AL" sh.p.k.,për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëvetë ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti